



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 110

**Tiranë – E martë, 16 maj 2017**

## PËRMBAJTJA

|  | Faqe |
|--|------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 412, datë 10.5.2017 | 5901 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 413, datë 10.5.2017 | 5901 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 416, datë 10.5.2017 | 5902 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 417, datë 10.5.2017 | 5903 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 10.5.2017 | 5908 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 10.5.2017 | 5913 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 420, datë 10.5.2017 | 5913 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 10.5.2017 | 5913 |

|   |   |      |
|---|---|------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 422, datë 10.5.2017 | Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Mërkur Bozgo.....  | 5914 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 423, datë 10.5.2017 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Urbanizim i zonës informale në lagjen “18 Tetori” Lushnjë” ..... | 5914 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 424, datë 10.5.2017 | Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës së përzgjedhjes e të emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare.....   | 5915 |
|   | Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Pëllump (Pëllumb) Beqiraj.....  | 5919 |

**VENDIM**

Nr. 412, datë 10.5.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN  
NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E  
PERSONAVE TË SHPALLUR SI  
FINANCUES TË TERRORIZMIT”,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C” të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”, çregjistrohen individët e renditur në shkronjën “a”, sipas ndryshimit bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE  
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË  
TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË  
SIGURIMIT

(LISTA E OKB-së)

C) LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE  
BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN  
ISIL (Da’esh) dhe AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”;

1. FRITZ; MARTIN; GELOWICZ
2. DIEMAN; ABDULKADIR IZZAT
3. ATA; ABDOULAZIZ; RASHID

Shënim: Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

**VENDIM**

Nr. 413, datë 10.5.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN  
NR. 400, DATË 1.6.2016, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E  
FORCAVE TË ARMATOSURA TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË  
OPERACIONIN USHTARAK TË  
BASHKIMIT EVROPIAN, ME MISION  
TRAJNUES, NË REPUBLIKËN E MALIT,  
NË AFRIKË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 103/2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për krijimin e kuadrit për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionet e menaxhimit të krizave të Bashkimit Evropian”, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 400, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “b”, të pikës 1, data “1 qershor 2017” ndryshohet dhe bëhet “30 qershor 2018”.

b) Në pikën 3, data “1 qershor 2017” ndryshohet dhe bëhet “30 qershor 2018”.

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare .

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi

VENDIM  
Nr. 416, datë 10.5.2017

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, NGA  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN NË  
DISA NJËSI TË QEVERISJES QENDRORE  
PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE TE  
REJA, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 19,  
DATË 12.4.2017, TË KOMITETIT PËR  
ZHVILLIMIN E RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet buxhetore, miratuar në buxhetin e vitit 2017 për Ministrinë e Zhvillimit Urban, në

programin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, rishpërndahen në disa institucione qendrore për financimin e projekteve të reja, të miratuara me vendimin nr. 19, datë 12.4.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për fond për përgatitje projektsh (projektim), thirrja I për vitin 2017, të grantit ‘Infrastruktura vendore dhe rajonale’, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I”, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Financave, Agjencia për Zhvillimin Rajonal 1, Agjencia për Zhvillimin Rajonal 2, Agjencia për Zhvillimin Rajonal 3 dhe Agjencia për Zhvillimin Rajonal 4 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi

Tabela nr.1 Rishpërndarja e fondeve buxhetore për projektet e reja të FZHR, për njësitë qendrore

| EQ                         | Gr | Kodi inst. | Emertimi I Institucionit | Kap. | Programi | Llog. ekon. | Kodi i Thesarit | Kodi i projektit | Shuma              | Emertimi i projektit te investimit   |
|----------------------------|----|------------|--------------------------|------|----------|-------------|-----------------|------------------|--------------------|--|
| <b>PAKËSOHET</b>           |    |            |                          |      |          |             |                 |                  |                    |  |
| 001                        | 94 | 1094001    | Aparati I MZHU           | 01   | 06210    | 2310000     | 3535            | M940115          | 200.000.000        | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve   |
| <b>Totali i pakësimeve</b> |    |            |                          |      |          |             |                 |                  | <b>200.000.000</b> |  |
| <b>SHTOHET</b>             |    |            |                          |      |          |             |                 |                  |                    |  |
| 01                         | 87 | 1087022    | AZHR-1                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3333            | Kod I ri         | 6.576.000          | Zhvillimi i Ballinave Ujore: Porti turistik i Liqenit të Shkodrës dhe limanet përgjate vijës liqenore; Buna Marina në Pulai - Veçpojë  |
| 01                         | 87 | 1087022    | AZHR-1                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3333            | Kod I ri         | 15.654.435         | Projektim i rrugës panoramike në bregun lindor të “Liqenit Shkodër”, me qëllim promovimin e itinerareve këmbësore dhe çiklistike, si dhe ndërhuja e rrugës respektive me itineraret ndërkombëtare ekzistuese   |
| 01                         | 87 | 1087022    | AZHR-1                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3333            | Kod I ri         | 15.360.640         | Përmirësimi i infrastrukturës ndërlidhëse ndërmjet Qarkut Shkodër dhe Qarkut Lezhë, nëpërmjet rikonstruksionit të aksit rrugor Ura Go Lullit – Torovicë – Ballëden   |
| 01                         | 87 | 1087022    | AZHR-1                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3333            | Kod I ri         | 3.852.000          | Tregu Rajonal Vëlot (Bashkia Kurbin)   |
| 01                         | 87 | 1087022    | AZHR-1                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3333            | Kod I ri         | 5.193.255          | Projekt ide përfundimtare për krijimin e terminalave inter-modale në qendrat urbane kryesore lidhëse, si dhe stacionet e bera mbështetëse në Zonën e Zhvillimit Rajonal 1  |
| 01                         | 87 | 1087022    | AZHR-1                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3333            | Kod I ri         | 3.363.670          | Projektim i terminalit të Autobusëve “Bashkia Kukës”   |
| 01                         | 87 | 1087023    | AZHR-2                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3535            | Kod I ri         | 28.000.000         | Krijimi i akseseve të reja dhe përmirësimi të lëvizshmërisë ndërmjet zonave për një kohezion dhe ndërvëprim ndërvendor dhe ndërrajonal   |
| 01                         | 87 | 1087023    | AZHR-2                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3535            | Kod I ri         | 5.000.000          | Ndërtimi i shtetores për këmbësorë dhe biçikleta përgjatë vijës bregdetare nga Komanda e Forcave Detare (Bashkia Durrës), deri tek peno i Leshnigje (Qerret Bashkia Kavajë)  |
| 01                         | 87 | 1087023    | AZHR-2                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3535            | Kod I ri         | 8.000.000          | Rikualifikimi i qendrës urbane të termave, të aksit rrugor që e lidh me qendrën e qytetit si dhe shndërrimin e zonës pyjore pranë termave në tre parqe të arreaduar të zonës së Bellovës, Dëbër dhe Bilaj, Fushë Krujë   |
| 01                         | 87 | 1087023    | AZHR-2                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3535            | Kod I ri         | 2.000.000          | Rivitalizimi i parkut rajonal të Bedenit si katalizator i zhvillimit rajonal si dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së komunitetit përreth tij  |
| 01                         | 87 | 1087023    | AZHR-2                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3535            | Kod I ri         | 7.000.000          | Ripërtëritje e Tregut Rajonal – Rigjenerim të tregjeve në Naqellarë-Shupenë-Klos dhe tregu Rogozhinë me qëllim ripërtëritjen e traditave të promovimit dhe tregtimt të produkteve bujqësore, blegtorale, artizanale dhe produkteve të tyre në rajon              |
| 01                         | 87 | 1087024    | AZHR-3                   | 01   | 01150    | 2300000     | 1515            | Kod I ri         | 40.000.000         | Hartim projekti për rivitalizimin e hapësirave publike dhe infrastrukturës në fshatrat e Rajonit 3   |
| 01                         | 87 | 1087024    | AZHR-3                   | 01   | 01150    | 2300000     | 1515            | Kod I ri         | 2.470.000          | Hartim projekti për ngritjen dhe funksionimin e tregut të markës në qytetin e Elbasanit  |
| 01                         | 87 | 1087024    | AZHR-3                   | 01   | 01150    | 2300000     | 1515            | Kod I ri         | 1.410.000          | Hartim projekti për ngritjen dhe funksionimin e terminalit të autobusave në qytetin e Elbasanit  |
| 01                         | 87 | 1087024    | AZHR-3                   | 01   | 01150    | 2300000     | 1515            | Kod I ri         | 1.410.000          | Hartim projekti për përcaktimin e Pikave Panoramike të Rajonit 3   |
| 01                         | 87 | 1087024    | AZHR-3                   | 01   | 01150    | 2300000     | 1515            | Kod I ri         | 1.810.000          | Hartim projekti për shtigjet e këmbësorëve dhe biçikletave që lidhin qytetin e Beratit me kodrat përreth Kalasë së Goricës   |
| 01                         | 87 | 1087024    | AZHR-3                   | 01   | 01150    | 2300000     | 1515            | Kod I ri         | 2.900.000          | Hartim projekti për Kanionet e Osunit  |
| 01                         | 87 | 1087025    | AZHR-4                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3737            | Kod I ri         | 15.000.000         | Përmirësimi i infrastrukturës rajonale: Unaza e Drinos; Krijimi i aksit rrugor kthesa e Libohovës-Suhë-Steq opul-Sarajinisht me një shtetësi rreth 12 km   |
| 01                         | 87 | 1087025    | AZHR-4                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3737            | Kod I ri         | 5.000.000          | Projektim i rrugës Fimiq-Bienimas, lidhëse e dy supertradave të reja që po ndërtohen Qafë Botë-Sarandë dhe Sarandë-Kardhiq me një gjatësi rreth 28 km me qëllim promovimin e zhvillimit rajonal turistik ekonomike social  |
| 01                         | 87 | 1087025    | AZHR-4                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3737            | Kod I ri         | 18.000.000         | Projektim i qendrave të fshatrave tradicionale, bregdetare e malore duke përfshirë zonën përgjatë lumit të Vlorës dhe anës detit Jon, me qëllim rivitalizimin e fasadave të banesave tradicionale, kthimin e qendrave në hapësira publike, pedonale me elejëbrim |
| 01                         | 87 | 1087025    | AZHR-4                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3737            | Kod I ri         | 7.500.000          | Projektim për përmirësimin e infrastrukturave ndërlidhëse, me qëllim rritjen e aksesueshmërisë në disa nga monumentet e kulturës së kategorisë së parë të qarkut Vlorë, në funksion të turizmit kulturor dhe natyror   |
| 01                         | 87 | 1087025    | AZHR-4                   | 01   | 01150    | 2300000     | 3737            | Kod I ri         | 4.500.000          | Projektim për përmirësimin e shërbimit ndërlokal me autobusë mes Vlorës, Himarës dhe Sarandës për promovimin e turizmit bregdetar dhe kulturor rajonal   |
| <b>Totali i shtesave</b>   |    |            |                          |      |          |             |                 |                  | <b>200.000.000</b> |  |

**VENDIM**

Nr. 417, datë 10.5.2017

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË  
EMERGJENCËS PËR GAZIN NATYROR,  
NË PËRPUTHJE ME STANDARDET  
MINIMALE TË SIGURISË SË  
FURNIZIMIT, SI DHE RREGULLAT PËR  
TË GARANTUAR FURNIZIM TË SIGURT  
DHE TË EFEKTSHËM ME GAZ  
NATYROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 1, shkronja “a”; 7, pikat 2, shkronja “a”, 3 e 4; 8, 9 dhe 116, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Enti Rregullator i Energjisë të marrin masa për monitorimin e zbatimit të planit të emergjencës për gazin natyror.

3. Ministria e Energjisë dhe Industrisë t'i dorëzojë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë planin e emergjencës për gazin natyror, jo më vonë se 30 ditë pas miratimit ose përditësimit përkatës.

4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi**

**PLANI I EMERGJENCËS PËR GAZIN  
NATYROR**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Plani e Emergjencës për Gazin Natyror (më poshtë referuar si “Plani i Emergjencës”) përcakton standardet, që kanë të bëjnë me kërkesat minimale të përshtatshme për sigurinë e furnizimit me gaz natyror në Republikën e Shqipërisë, kriteret e detyrueshme për sigurimin e furnizimit të besueshëm dhe efikas me gaz natyror si dhe detyrat

dhe përgjegjësitë e institucioneve për menaxhimin e situatave të emergjencës në furnizimin me gaz të klientëve.

2. Plani i Emergjencës, specifikisht, përfshin sa më poshtë:

2.1 Përcaktimin e standardeve që kanë të bëjnë me kërkesat minimale të përshtatshme të sigurisë së furnizimit;

2.2 Instrumente dhe masa që garantojnë sigurimin në një masë të përshtatshme dhe të përcaktuar qartë të furnizimit me gaz për klientët e mbrojtur, duke përmbushur standardet e sigurisë së furnizimit;

2.3 Instrumente dhe masa për parashikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të mundshme, që caktojnë qartë veprimet për parandalimin e këtyre rreziqeve dhe lehtësimin e dëmeve të mundshme të lidhura me to;

2.4 Një program për zvogëlimin ose ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror për kategori të veçanta klientësh në rast të një situatë krize në sektorin e gazit natyror;

2.5 Rolin dhe përgjegjësitë e sipërmarrësve të gazit dhe konsumatorëve jofamiljarë, duke marrë në konsideratë masat e ndryshme të ndikimit në rast të një situatë krize në sektorin e gazit natyror;

2.6 Kriteret në lidhje me impiantet e depozitimit, me qëllim përmbushjen e standardeve të sigurisë së furnizimit, si dhe kontribute të mundshme për impiantet e depozitimit të vendosura ose në Republikën e Shqipërisë ose në një palë tjetër kontraktuese në Komunitetin e Energjisë, apo vend anëtar të Bashkimit Evropian;

2.7 Masa dhe veprime të tjera me rëndësi, që do të ndërmerren për eliminimin apo lehtësimin e ndikimit nga një ndërprerje e furnizimit me gaz natyror, zbatuar duke marrë në konsideratë nivelet e përcaktuara qartë të krizës.

3. Pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror planifikojnë dhe marrin masa për një furnizim të sigurt me gaz natyror në përputhje me këtë plan emergjence dhe janë përgjegjës për sigurimin e furnizimit me gaz natyror në kuadër të veprimtarive të tyre.

4. Të gjitha termat e përdorura në këtë plan emergjence, që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë plan, përdoren në përputhje me kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.



5. Plani i Emergjencës përditësohet periodikisht, por jo më rrallë se çdo 2 (dy) vjet. Çdo ndryshim i planit të emergjencës do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

## II. KLIENËTË E MBROJTUR

6. Të gjithë klientët familjarë, të lidhur me rrjetin e shpërndarjes të gazit natyror, konsiderohen si klientë të mbrojtur, në kuadrin e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, këtij plani emergjence dhe akteve të tjera ligjore përkatëse.

7. Klientët jofamiljarë, të lidhur me rrjetin e shpërndarjes së gazit natyror, dhe shërbimet shoqërore thelbësore, të lidhura me rrjetin e shpërndarjes së gazit natyror, konsiderohen klientë të mbrojtur, nëse këta klientë nuk përfaqësojnë më shumë se 20% të konsumit përfundimtar të gazit natyror.

8. Instalimet e ngrohjes së ndërtesave, të lidhura me rrjetin e shpërndarjes së gazit natyror, konsiderohen klientë të mbrojtur në rastet kur plotësohen të kushtet në vijim:

8.1 Ngrohja u ofrohet klientëve familjarë dhe/ose klientëve të përcaktuar në pikën 6;

8.2 Këto instalime të ngrohjes së ndërtesave nuk kanë aftësi të përdorin lëndë djegëse të tjera.

## III. STANDARDET (KËRKESAT) E SIGURISË SË FURNIZIMIT

9. Të licencuarit përgjegjës për furnizimin me gaz natyror si një shërbim publik, sipas përcaktimeve dhe dispozitave të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, janë përgjegjës për sigurimin e furnizimit me gaz natyror për klientët e mbrojtur të mbuluar prej tyre, në rast të ngjarjeve të mëposhtme:

9.1 Temperatura ekstreme të ulëta përgjatë një periudhe dimërore piku 7 (shtatë) ditore, që ka probabilitet statistikor të ndodhë një herë në 20 (njëzet) vite;

9.2 Të gjitha periudhat prej, të paktën, 30 (tridhjetë) ditë, me kërkesë jashtëzakonisht të lartë për gaz natyror, që kanë probabilitet statistikor të ndodhin një herë në 20 (njëzet) vjet;

9.3 Një periudhë prej, të paktën, 30 (tridhjetë) ditë, në rastin e ndërprerjes së infrastrukturës së vetme më të madhe të infrastrukturës së gazit në kushte dimërore mesatare.

10. Përcaktimet e renditura në pikën 9 konsiderohen standardet minimale të sigurisë së furnizimit.

## IV. MASAT PARANDALUESE

11. Ministria përcakton masa parandaluese për gazin në vitin pasardhës, bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut.

12. Ministria përcakton fushështrirjen e vlerësimit të rrezikut dhe e ndërmerr vlerësimin çdo 2 vjet, nëse rrethanat nuk paraqesin nevojën për përditësim më të shpeshta.

13. Masat parandaluese përcaktojnë gamën e detyrimeve të subjekteve të tregut të gazit natyror dhe afatet për përmbushjen e tyre.

14. Masat parandaluese bazohen, kryesisht, në parimet e tregut dhe përcaktohen bazuar në:

- ndikimin e tyre në funksionimin e tregut të gazit natyror;

- ndikimin në mjedis;

- ndikimin të klienti.

Masat parandaluese nuk vendosin një barrë të papërshtatshme mbi pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror dhe minimizojnë pasojat negative në funksionimin e tregut të gazit natyror.

## V. NIVELET E KRIZËS SË EMER-GJENCËS

15. Ky plan emergjence përcakton përgjegjësitë dhe masat që kanë si qëllim të garantojnë sigurinë e furnizimit, në rast të tre nivele kryesore të krizës:

15.1 Lajmërimi i hershëm: kur ka informacion konkret, serioz dhe të besueshëm që mund të ndodhë një ngjarje që ka gjasa të shkaktojë përkeqësim të situatës së furnizimit dhe që mund të sjellë nivele më të larta krize nëse nuk zgjidhet siç duhet;

15.2 Nivel alarmi: kur ndodh ndërprerje e furnizimit ose kërkesë jashtëzakonisht e lartë për gaz natyror dhe kjo shkakton përkeqësim të konsiderueshëm të situatës së furnizimit, por tregu është akoma në gjendje t'i përgjigjet përkeqësimit ose kërkesës pa patur nevojë të mbështetet në masa jashtë tregut;

15.3 Niveli i emergjencës: në rast të një kërkesë të jashtëzakonshme për gaz natyror, ndërprerje të konsiderueshme të furnizimit apo përkeqësime të tjera të konsiderueshme të situatës së furnizimit dhe rastet kur të gjitha masat përkatëse të tregut janë zbatuar, por furnizimi me gaz natyror nuk mjafton për përmbushjen e kërkesës dhe duhet të ndërmerren masat jashtë tregut për të siguruar furnizimin klientëve të mbrojtur.

16. Ministria është autoriteti përgjegjës për njoftimin e fillimit dhe përfundimit të nivelit të



krizës, bazuar në informacionin e siguruar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe/ose Enti Rregullator i Energjisë.

17. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë të detyruar të informojnë Ministrinë, pa vonesa, në lidhje me të gjitha situatat e vëna re në sistemin e transmetimit, që mund të shkaktojnë një nivel të njoftimit të hershëm dhe, si rrjedhojë, nivele më të larta krize.

18. Gjatë zbatimit të monitorimit për sigurinë e furnizimit, në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në ligjin nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE ka detyrimin të njoftojë Ministrinë në lidhje me të gjitha situatat që mund të rezultojnë në një nivel të çfarëdoshëm krize.

#### VI. KOMITETI I EMERGJENCËS

19. Ministri i Energjisë dhe Industrisë ngre Komitetin e Krizës, si një organ të përkohshëm konsultimi dhe këshillimi pas njoftimit të nivelit të krizës.

20. Komiteti i Emergjencës përbëhet nga përfaqësues të:

- ministrisë;
- Operatorit të Sistemit të Transmetimit; si dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
- furnizuesit që kryen furnizimin me gaz natyror si një shërbim publik;
- furnizuesit të mundësisë së fundit;
- palë të tjera interesi sipas vendimit të Ministrit.

21. Komiteti i Emergjencës drejtohet nga një përfaqësues i lartë Ministrisë dhe mbledhet çdo ditë, nëse është e nevojshme.

22. Komiteti i Emergjencës ndihmon Ministrinë me përgatitjen dhe zbatimin e masave që synojnë të eliminojnë ose lehtësojnë ndikimin e përgjithshëm negativ të një situatë krize dhe, në veçanti, analizon informacionin e përftuar nga vetë komiteti apo nga pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror, sipas përcaktimeve të planit të emergjencës, bën rekomandime për miratimin e vendimit për ndodhinë ose përfundimin e situatës së krizës si dhe për përcaktimin e nivelit të krizës.

Ministria, bazuar në rekomandimet e Komitetit të Emergjencës dhe në rezultatet e vlerësimit të riskut, në rastin kur vendi ka një nivel të përshtatshëm të interkoneksionit, mund të marrë masat e duhura në mënyrë që të arrihen kërkesat (kriteret) e sigurisë së furnizimit, duke bashkë-

punuar me autoritetet dhe/ose shoqëritë e gazit natyror të një vendi të BE-së ose të një pale tjetër të Komitetit të Energjisë. Aplikimi i këtyre masave nuk duhet të pengojë funksionimin normal të tregut vendas.

23. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Komitetit të Emergjencës përfundon me fundin e situatës së emergjencës

#### VII. PËRGJEGJËSITË DHE MASAT E ZBATUESHME NË RAST KRIZE

A. Përgjegjësitë dhe masat e zbatueshme në rast të një niveli të njoftimit të hershëm

24. Pas vendimit të vërtetimit të një situatë emergjence në nivelin e njoftimit të hershëm, Ministria ngre Komitetin e Emergjencës, në përputhje me kreun VI.

25. Pas njoftimit të nivelit të njoftimit të hershëm, furnizuesit duhet t'i dorëzojnë informacion kryetarit të Komitetit të Emergjencës çdo ditë, në lidhje me volumet e parashikuara të konsumit total të gazit natyror nga klientët e tyre dhe të volumeve të konsumit nga klientët e tyre të konsideruar si të mbrojtur.

26. Ministria, bazuar në analizën e ndërmarrë nga Komiteti i Emergjencës, përcakton listën e masave, bazuar në treg, që duhen ndërmarrë për lehtësimin e ndikimit të situatës së emergjencës me njoftim të hershëm dhe për parandalimin e përshkallëzimit të emergjencës në nivele më të larta.

B. Përgjegjësitë dhe masat e zbatueshme në rast të një niveli alarmi

27. Pas marrjes së vendimit për dhënien e njoftimit në lidhje me situatën e krizës në nivelin e alarmit, Ministria:

27.1 u jep udhëzime operatorëve të sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes për përgatitjen e listave sipas kategorive të volumeve të konsumit, për të hartuar një plan veprimtarie për ndërprerjen (kufizimin) e transmetimit/shpërndarjes së gazit natyror, kur është e nevojshme, dhe për dorëzimin e tij të kryetari i Komitetit të Emergjencës;

27.2 informon klientin, nëpërmjet mediave, në lidhje me nivelin e krizës dhe ndërprerjen (kufizimin) e mundshëm të furnizimit me gaz natyror;

27.3 përcakton listën e masave, bazuar në treg, që do të ndërmerren nga pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror;

27.4 jep udhëzime në lidhje me regjimin e punës së impianteve të prodhimit të nxehtësisë dhe



energjisë elektrike që konsumojnë gaz natyror si lëndë djegëse;

27.5 jep udhëzime në lidhje me orët e punës së institucioneve publike që përdorin gaz natyror për ngrohje;

27.6 përcakton pikat e ngrohjes për popullatën, që do të bëhen aktive nëse është e nevojshme;

27.7 harton programin për reduktimin gradual të furnizimit me gaz natyror që do të përdoret nëse kriza përshkallëzon në nivelin e emergjencës.

28. Monitorimi i një situatë krize në nivelin e lajmërimit, përfitim dhe analizimi i të gjithë informacionit të nevojshëm të marrë nga pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror ndërmerret nga Komiteti i Krizës.

C. Përgjegjësitë dhe masat e zbatueshme në rast të një niveli emergjence

29. Pas vendimit për njoftimin e një situatë krize në nivelin e emergjencës, Ministria përcakton listën e masave të bazuara në treg dhe jashtë tregut që do të ndërmerren për të lehtësuar krizën.

30. Masat e bazuara jashtë tregut zbatohen vetëm në ato raste kur masat e bazuara në treg nuk garantojnë sigurinë e furnizimit me gaz natyror, veçanërisht për klientët e mbrojtur. Ministria përcakton listën e masave të bazuara jashtë tregut, duke marrë në konsideratë ndikimin e pritshëm të masave të bazuara në treg gjatë situatës së krizës në nivel emergjence.

31. Ministria vendos ndërmarrjen e një ose më shumë prej masave të mëposhtme për të eliminuar një situatë krize në nivelin e emergjencës:

31.1 Ndryshimin e llojit të lëndës djegëse për të gjithë klientët, përveç atyre të mbrojtur, që e kanë këtë mundësi;

31.2 Zbatimin e detyruar të termave të kontratës, që lejojnë ndërprerjen (përfundimin) e vetë furnizimit me gaz natyror në disa raste;

31.3 Ndryshimin e orarit të punës së kompanive shtetërore, bashkiake apo private, institucioneve, autoriteteve dhe organizatave në ato raste kur këto subjekte përdorin gaz natyror për ngrohje ose u ofrohet ngrohje nga një kompani komunale ngrohjeje që përdor gaz natyror;

31.4 Zvogëlimin e furnizimit me gaz natyror për disa klientë, bazuar në një program të hartuar nga Ministria, në përputhje me pikat 27.7 dhe 32, dhe njoftimin e klientëve në lidhje me këtë zvogëlim;

31.5 Mbylljen e shkollave dhe institucioneve të arsimit të lartë;

31.6 Hapjen e strehëzave publike dhe qendrave për ngrohje.

32. Ndërprerja ose kufizimi i furnizimit me gaz natyror bëhet sipas rendit në vijim:

32.1 Centralet prodhuese të energjisë elektrike, që përdorin gaz natyror si lëndë djegëse;

32.2 Klientët e mëdhenj industrialë, që përdorin gaz natyror si lëndë djegëse për kogjenerim;

32.3 Klientët e tjerë të mëdhenj industrialë;

32.4 Klientët e mesëm industrialë, që përdorin gazin natyror si lëndë djegëse për kogjenerim;

32.5 Klientët e tjerë të mesëm industrialë;

32.6 Klientët e mbrojtur.

33. Ndërprerja ose kufizimi i furnizimit me gaz natyror lejohet vetëm kur tregtarët dhe furnizuesit në tregun e gazit natyror kanë ndërmarrë të gjitha masat e tjera të mundshme për të përmbushur kërkesën e klientëve që jetojnë ose kanë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

34. Në rastin e një situatë krize në nivelin e emergjencës, operatorët e sistemit të shpërndarjes, operatorët e impianteve të depozitimit, prodhuesit e gazit natyror dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut të gazit natyror zbatojnë urdhrat dhe udhëzimet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit në lidhje me regjimin e veprimtarisë së sistemit të transmetimit.

#### VIII. PËRDORIMI I INSTALIMEVE TË IMPIANTEVE TË DEPOZITIMIT

35. Kur është e nevojshme dhe teknikisht e mundshme, Ministria mund të caktojë një sërë masash të veçanta për përdorimin e instalimeve të impianteve të depozitimit që ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim përmbushjen e standardeve të sigurisë së furnizimit, përfshirë edhe ato që lidhen me masat e përcaktuara në kreun VII.

36. Të gjitha masat e përcaktuara sipas pikës 35 zbatohen si një detyrim me përparësi, pavarësisht marrëveshjeve kontraktuale për shpërndarjen e kapaciteteve të depozitimit, dhe në përputhje me regjimin e veprimtarisë së sistemit të transmetimit, të përcaktuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

37. Nëse mundësohen nga kapacitetet ekzistuese të interkonjeksioneve, Ministria ose shoqëria përgjegjëse e gazit natyror mund të marrë masa të përshtatshme për përmbushjen e standardeve (kërkesave) të sigurisë së furnizimit, duke përdorur ambientet e depozitimit që gjenden në territorin e një pale tjetër kontraktuese në





Komunitetin e Energjisë apo një vendi anëtar në BE-së. Për këtë qëllim mund të zbatohen bashkëpunime me palën kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose vendin anëtar të BE-së përkatës, përfshirë edhe nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe. Zbatimi i këtyre masave nuk pengon funksionimin normal të tregut të brendshëm të gazit natyror.

38. Të gjitha masat e ndërmarra nga shoqëria e gazit natyror, në përputhje me pikën 37, konsultohet me Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe i raportohet Ministrisë menjëherë.

#### IX. BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN E ENERGJISË

39. Ministria ia komunikon rezultatet e vlerësimit të rrezikut Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

40. Ministria e shkëmben këtë plan emergjence me palën kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ose vendin anëtar të BE-së në nivelin e përshtatshëm rajonal, me qëllim garantimin e rëndësisë së ndërsjellë të masave të përcaktuara në të.

41. Në rast të një situatë emergjence, pavarësisht nivelit, Ministria njofton çdo ditë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe kryesinë e grupit të koordinimit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me sigurinë e furnizimit si dhe në lidhje me gjendjen e krizës e masat e ndërmarra për të eliminuar situatën, në përputhje me këtë plan emergjence. Shkëmbimi i informacionit bëhet nëpërmjet kanaleve të disponueshme të komunikimit.

42. Nëse zbatimi i masave të bazuara në treg dhe atyre jashtë tregut, në nivel kombëtar, nuk garantojnë eliminimin e situatës së krizës, Ministria njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe kryesinë e grupit të koordinimit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me sigurinë e furnizimit. Ky njoftim përfshin informacionin e mëposhtëm:

42.1 Përshkrimin e rrethanave dhe ndikimin e tyre në sigurinë e energjisë të Republikës së Shqipërisë, në kuadrin e sigurisë së furnizimit me gaz natyror;

42.2 Masat e ndërmarra për të eliminuar apo lehtësuar ndikimin e përgjithshëm negativ të një situatë krize;

42.3 Propozimet në lidhje me masat për të eliminuar një situatë krize që do të zbatohen në nivelin e Komunitetit të Energjisë.

43. Në ato raste kur kërkohet nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ose nga grupi i koordinimit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me sigurinë e furnizimit, Ministria ndërmer masat e synuara për parandalimin ose lehtësimin e situatës të krizës dhe që garantojnë përputhshmëri me qëllimet e sigurisë së furnizimit në nivelin e Komunitetit të Energjisë dhe/ose, ndër të tjera, që shmangin zbatimin e tyre me diskriminim ose ngarkimin e barrëve të padrejta pjesëmarrësve në tregun e gazit natyror.

44. Brenda 2 (dy) muajve, nga përfundimi i situatës së krizës, Ministria miraton një raport që paraqet përshkrimin e një situatë krize dhe ndikimet e saj (veçanërisht ato financiare), si dhe një analizë të efikasitetit të masave të ndërmarra për eliminimin e situatës, dhe ia dorëzon Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe kryesinë së grupit të koordinimit të Komunitetit të Energjisë për sigurinë e furnizimit. Informacioni i detajuar në këtë raport përdoret për të përditësuar planin e emergjencës.

#### X. DISPOZITAT E FUNDIT

45. Të gjitha masat mbrojtëse në lidhje me sigurinë e furnizimit, të ndërmarra sipas këtij plani emergjence, përcaktohen dhe zbatohen në mënyrë të tillë që të shkaktojnë shqetësimin më të vogël të mundshëm për veprimtarinë e tregut të brendshëm dhe nuk kanë shtrirje më të gjerë se sa është ngushtësisht e nevojshme për tejkalimin e vështirësive të papritura që janë hasur. Të gjitha këto masa zbatohen, përkohësisht, në mënyrë objektive, transparente e jodiskriminuese dhe raportohen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

46. Ministria dhe ERE, në kuadër të kompetencave të tyre, garantojnë zbatimin dhe realizimin e këtij plani emergjence.

47. Ministria, në bashkëpunim me ERE-n, harton një raport vjetor për zbatimin e këtij plani emergjence, përfshirë të gjitha masat e sigurisë së furnizimit që mund të jenë zbatuar sipas tij, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”. Ky raport i dorëzohet Këshillit të Ministrave dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, pasi të jetë përkthyer në gjuhën angleze.



**VENDIM**  
**Nr. 418, datë 10.5.2017**

**PËR STANDARDET, KRITERET DHE  
PROCEDURAT PËR HAPJEN,  
RIORGANIZIMIN, NDARJEN,  
BASHKIMIN OSE MBYLLJEN E  
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË  
LARTË DHE TË DEGËVETË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 29, 30 e 31, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Subjekte juridike, vendase ose të huaja, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, depozitojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit projektin për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë ose degë të një institucioni ekzistues. Afati fundor i depozitimit është data 15 maj, për vitin e dytë pasardhës akademik.

2. Subjekti kërkues për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë duhet të përmbushë standardet e mëposhtme:

a) Standardet e organizimit të IAL-së:

i) Organi më i lartë akademik i IAL-së është Senati Akademik.

ii) Organi më i lartë administrativ i IAL-së është Bordi i Administrimit.

iii) Autoriteti më i lartë akademik i IAL-së është Rektori. Rektori është personel akademik me kohë të plotë.

iv) Autoriteti më i lartë administrativ i IAL-së është administratori i saj.

v) Autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore është Dekani. Dekani është personel akademik me kohë të plotë.

vi) Autoriteti më i lartë administrativ i njësisë kryesore është administratori i saj.

vii) Autoriteti më i lartë akademik i njësisë bazë është drejtuesi i saj. Drejtuesi i njësisë bazë është personel akademik me kohë të plotë.

viii) Autoriteti më i lartë administrativ i njësisë bazë është administratori i saj. Ai është personel administrativ me kohë të plotë.

ix) Asambleja e personelit akademik është

organi i IAL-së, që zgjedh rektorin, dekanin dhe organet akademike të IAL-së.

x) Një institucion i arsimit të lartë organizohet në njësi përbërëse kryesore dhe bazë, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për arsimin e lartë, duke respektuar llojin e institucionit.

xi) Çdo njësi kryesore duhet të ketë, të paktën, tre njësi bazë, që grupojnë disiplina mësimore të përafërta ose të ndërthurura dhe që përfshijnë fusha kërkimi respektive.

xii) Njësi bazë duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik.

xiii) Një institucion i huaj i arsimit të lartë apo degë e tij, që zotëron një formë akreditimi në një shtet tjetër, mund të ketë organizim tjetër strukturor, në varësi të formës në shtetin e origjinës.

b) Standardet për personelin akademik të IAL-së:

i) Standardi i raportit personel akademik me kohë të plotë/student, sipas fushave kryesore të studimit, është sipas shkronjës “A”, të aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

ii) Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi.

c) Standarde dhe normativa për infrastrukturën e IAL-së:

i) Standardet ndërtimore të IAL-ve të jenë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për institucionet arsimore dhe ato të jenë të vendosura larg varrezave apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara, sipas standardeve përkatëse.

ii) Objektet që do të përdoren për hapjen e institucioneve të arsimit të lartë duhet të përmbajnë, minimalisht, ambientet sipas shkronjës “B”, të aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, dhe natyrës së programeve të studimit që do të ofrojnë.

iii) Objektet që do të ofrohen për institucionet e arsimit të lartë, duhet të plotësojnë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, të ndara sipas fushave të studimit, sipas shkronjës “C”, të aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

iv) Numri i studentëve, sipas veprimtarive akademike, nuk duhet të jetë më i madh se numri i përcaktuar në shkronjës “D”, të aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.



ç) Objektet e arsimit të lartë, me më shumë se 200 studentë (në një godinë), detyrimisht duhet të jenë të pajisur me dalje dhe shkallë emergjence.

d) Të gjitha objektet, që do të shërbejnë si institucione të arsimit të lartë, duhet të kenë të instaluar sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit ose të jenë kompletuar (sipas normativave përkatëse) me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundra zjarrit si dhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike.

dh) Institucionet e arsimit të lartë duhet të jenë të pajisura me pikën e ndihmës së shpejtë/mjedisi shëndetësor dhe mjetet e pajisjet e nevojshme për ketë qëllim.

e) Objektet e arsimit të lartë duhet të kenë të garantuar burime alternative për furnizimin me energji elektrike si edhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm.

ë) Mjediset e IAL-ve duhet të jenë të pajisura me sisteme funksionuese ngrohje-ftohjeje.

3. Për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë të respektohet procedura e mëposhtme:

a) Kërkesa dhe dokumentacioni për hapjen e institucionit të arsimit të lartë depozitohen në ministrinë përgjegjëse të arsimit të lartë.

b) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë verifikon plotësimin e standardeve dhe të kritereve për hapjen e IAL-së. Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, për vlerësimin e plotësimit të tyre, cakton ekspertë të jashtëm nga lista e ASCAL-it. Shpenzimet e ekspertit paguhen nga kërkuesi.

c) Eksperti/ASCAL-i, brenda 3 javëve, dorëzon raportin e vlerësimit në MAS. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga eksperti, subjektit i kërkohet plotësimi i tij, brenda tre javëve nga marrja e raportit të vlerësimit. Nëse edhe pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet sipas këtij vendimi, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë njofton subjektin/aplikuesin për refuzimin e kërkesës.

ç) Në rastin e refuzimit të një projekti të paraqitur, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë informon aplikantin për vendimin dhe shkaqet e marrjes së tij, brenda një afati 30-ditor nga data e aplikimit.

d) Nëse vlerësimi dhe vendimi përfundimtar është pozitiv, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë i propozon Këshillit të Ministrave hapjen e institucionit të arsimit të lartë.

dh) Pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të

Ministrave për miratimin e hapjes së institucionit të arsimit të lartë, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë nxjerr urdhrin për fillimin e veprimtarisë së institucionit.

e) Kur subjekti juridik kërkon të transferojë aktin e hapjes së IAL-s një subjekti tjetër juridik, ai duhet të marrë paraprakisht miratimin me shkrim nga ministri përgjegjës për arsimin e lartë. Subjekti juridik që ka marr të drejtën, duhet të përmbushë të gjitha kushtet dhe standardet e përcaktuara, të cilat verifikohen në vijimësi nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë.

4. Për riorganizimin e një institucioni të arsimit të lartë të respektohet procedura e mëposhtme:

a) Kërkesa dhe dokumentacioni depozitohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë. Iniciativa për riorganizimin e IAL-së/IAL-ve merret nga IAL-të e interesuara, me vendim të organeve kolegjiale të saj.

b) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, për vlerësimin e dokumentacionit, cakton ekspertë të jashtëm nga lista e ASCAL-it. Shpenzimet e ekspertit paguhen nga kërkuesi.

c) Eksperti/ASCAL-i, brenda 3 javëve, dorëzon raportin e vlerësimit në MAS. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë njofton subjektin për plotësimin e tij, brenda 2 javëve nga marrja e raportit të vlerësimit.

ç) Në rast se tre javë pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet, kërkesa refuzohet dhe dosja e aplikimit arkivohet. Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rastin e vlerësimit negativ, njofton me shkrim institucionin kërkues për vendimin e tij, të argumentuar, dhe praktika arkivohet.

d) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rast të vlerësimit pozitiv, nxjerr aktin e riorganizimit të institucionit të arsimit të lartë, jo më vonë se 3 muaj pas dorëzimit të dokumentacionit.

5. Për ndarjen ose bashkimin e një institucioni të arsimit të lartë, të respektohet procedura e mëposhtme:

a) Kërkesa dhe dokumentacioni për bashkimin e dy ose më shumë IAL-ve ekzistuese për krijimin e një IAL-je të vetme apo ndarjen e IAL-së në dy ose më shumë IAL, nga një IAL e vetme ekzistuese, merret nga vetë institucioni/institucionet e interesuara. Procesi i bashkimit ose ndarjes nuk duhet të cenojë standardet e sigurimit të cilësisë.



b) Në rastet e shkrirjes së IAL-ve, përgjegjësitë dhe asetet e IAL-ve të mëparshme i transferohen IAL-së së re, ndërsa, në rastet e përfshirjes së IAL-ve në procesin e bashkimit, ngelet një IAL e vetme, e cila administron përgjegjësitë dhe asetet edhe të IAL-së/IAL-ve të përfshira.

c) IAL-të e përfshira në procesin e bashkimit ose të ndarjes janë përgjegjëse për realizimin e procesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar një vijimësi normale të procesit akademik si dhe mbrojtjen e të drejtave të palëve të përfshira në këtë proces.

ç) Autoritetet drejtuese të IAL-së/IAL-ve pjesëmarrëse në këtë proces janë përgjegjëse për realizimin e tij. Menaxhimi financiar dhe administrativ në procesin e bashkimit ose të ndarjes, gjatë periudhës tranzitore, bëhet në përputhje me statutin e IAL-ve dhe legjislacionin në fuqi.

d) Kërkesa dhe dokumentacioni për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë depozitohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë.

dh) Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë njofton IAL-në/IAL-të për plotësime përkatëse. Nëse brenda tre javëve, nga marrja e njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet sipas këtij vendimi, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë njofton subjektin aplikues për refuzimin e kërkesës.

e) Në rastin e refuzimit të kërkesës së paraqitur, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë informon aplikantin për vendimin dhe për shkaqet e marrjes së tij brenda një afati 90-ditor, nga data e aplikimit. Praktika arkivohet në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë.

ë) Nëse vlerësimi dhe vendimi përfundimtar është pozitiv, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë i propozon Këshillit të Ministrave ndarjen/bashkimin e institucionit/institucioneve të arsimit të lartë.

6. Për mbylljen e institucionit/eve të arsimit të lartë ose të degëve të tyre të respektohet procedura dhe kriteret e mëposhtme:

a) Mbyllja e IAL-së bëhet, në çdo rast, me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës të arsimit të lartë, ndërsa mbyllja e degëve të IAL-ve bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin e lartë. Vendimi

përkatës i Këshillit të Ministrave dhe urdhri përkatës i ministrit përgjegjës për arsimin e lartë përcaktojnë pasojat dhe detyrimet që lindin, përkatësisht, nga mbyllja e IAL-së/ve ose degëve të tyre.

b) Në rastet e mbylljes së IAL-së vullnetarisht, nga vetë institucioni, nevojitet propozimi i senatit akademik dhe miratimi i bordit të administrimit.

c) Në rastet e mbylljes së IAL-së me nismën e ministrit përgjegjës për arsimin e lartë, nevojitet, paraprakisht, mendimi i senatit akademik dhe i bordit të administrimit, të cilët shprehen brenda një muaji, nga data e propozimit të dërguar nga ministri.

ç) Një institucion i arsimit të lartë mbyllet detyrimisht, si pasojë e:

i) shkeljeve të konstatuara nga kontrolli i ligjshmërisë;

ii) shkeljeve të konstatuara nga auditimi i IAL-së;

iii) vlerësimit negativ nga procesit i akreditimit institucional.

d) Ministri përgjegjës për arsimin e lartë, në rast konstatimesh të shkeljeve të ligjshmërisë, mund të vendosë edhe kushte, si masë paraprake, mosplotësimi i të cilave brenda afateve të përcaktuara çon në mbylljen e IAL-së.

dh) Ministri përgjegjës për arsimin e lartë, në rast konstatimesh të shkeljeve të ligjshmërisë, vijimësia e të cilave sjellë dëme të rënda dhe të pariparueshme për interesin publik, vendos për pezullimin e veprimtarisë së IAL-së, si masë e ndërmjetme deri në vendimmarrje përfundimtare. Pezullimi mund të jetë i pjesshëm ose i plotë, me afat deri në dy vjet.

e) Mbyllja e IAL-së bëhet kur IAL-ja nuk përmbush kriteret thelbësore të hapjes, shkel rëndë detyrimet e përcaktuara në të, për përfitime abuzive që rëndojnë mbi interesat ekonomike të studentëve, si dhe kur marrja e të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë është realizuar nëpërmjet mashtrimit, falsifikimit të dokumenteve, pasqyrimin të të dhënave të pavërteta dhe çdo shkeljeje tjetër të procedurës administrative. Konstatimi i mosplotësimit të kriterëve apo shkeljes së detyrimeve bëhet si rregull nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë.

7. Për hapjen e degëve të institucioneve të arsimit të lartë të respektohet procedura dhe kriteret e mëposhtme:



a) Institucionet e arsimit të lartë, që kanë seli qendrore dhe kryejnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, kanë të drejtë, brenda kompetencave dhe fushave të veprimtarive të tyre akademike, të hapin degë të tyre jashtë selisë qendrore, për të ofruar programe të studimeve, kërkim shkencor, veprimtari trajnuese, shërbime dhe veprimtari të tjera.

b) Këtë të drejtë e kanë edhe institucione të arsimit të lartë me seli qendrore jashtë Republikës së Shqipërisë. Këto institucione duhet të jenë të akredituara në vendin e tyre të origjinës. Dega e institucionit të arsimit të lartë, që e ka selinë qendrore jashtë Republikës së Shqipërisë, organizohet dhe administrohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

c) Dega e institucionit të arsimit të lartë, vendas ose e huaj, është:

i) pjesë përbërëse e njësive të selisë qendrore të institucionit;

ii) njësi e veçantë në strukturën e institucionit të arsimit të lartë, si njësi kryesore ose njësi bazë.

ç) Degët e IAL-ve, që kanë seli qendrore dhe kryejnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, duhet të:

i) përmbushin standardet akademike për personelin akademik;

ii) përmbushin standardet infrastrukturore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe përcaktimeve të këtij vendimi;

iii) paraqesin plan-biznesin,

iv) marrin përsipër mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e veprimtarisë së tyre akademike, për një periudhë, të paktën 3-vjeçare.

v) vetëdeklarojnë, në çdo rast, burimin e financimit.

d) Institucionet e arsimit të lartë, që kanë seli qendrore në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj dhe që duan të hapin degë të tyre në Republikën e Shqipërisë, paraqesin pranë ministrisë përgjegjëse

për arsimin e lartë dosjen e aplikimit jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti.

dh) Në rastet e hapjes së degës në nivel njësie bazë, në Republikën e Shqipërisë, institucioni i arsimit të lartë duhet të depozitojë në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë dosjen e aplikimit, jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti.

e) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rast të vlerësimit pozitiv të dosjes, nxjerr aktin e hapjes së degës në nivel njësie kryesore dhe në nivel njësie bazë për institucionet e arsimit të lartë, me seli qendrore jashtë Republikës së Shqipërisë, jo më vonë se 3 muaj pas dorëzimit të dosjes.

ë) Në rastet e hapjes së degës në nivel njësie bazë, për institucionet e arsimit të lartë brenda Republikës së Shqipërisë, pas vendimit të senatit akademik dhe miratimit të bordit të administrimit, njoftohet ministria përgjegjëse për arsimin e lartë brenda 30 ditëve.

f) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rastin e vlerësimit negativ, njofton me shkrim institucionin kërkues dhe praktika arkivohet.

8. Projektet e paraqitura për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin apo mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë ose të degëve të tyre përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, trajtohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në kohën e paraqitjes së projektit.

9. Projekti për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë ose degë të një institucioni ekzistues, përjashtimisht për vitin 2017, mund të paraqiten deri më 30 qershor, për vitin e dytë pasardhës akademik.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**



## ANEKSI 1

A. Standardi i raportit personel akademik me kohë të plotë / student, sipas fushave kryesore të studimit, është si më poshtë:

| Fusha                              | Personeli akademik | Studentë |
|------------------------------------|--------------------|----------|
| Shkencat natyrore                  | 1                  | 45       |
| Inxhinieri dhe teknologji          | 1                  | 35       |
| Shkenca mjekësore dhe shëndetit    | 1                  | 35       |
| Shkenca bujqësore dhe veterinarisë | 1                  | 45       |
| Shkenca sociale                    | 1                  | 45       |
| Shkenca humane dhe arte            | 1                  | 45       |

B. Ambientet minimale të nevojshme për hapjen e institucioneve të arsimit të lartë, sipas natyrës së programeve të studimit që do të ofrohen, janë si më poshtë:

1. Auditorë mësimi;
2. Ambiente për laboratorë dhe ndjekje praktikash klinike mjekësore;
3. Ambiente për personelin akademik;
4. Ambiente për personelin administrativ;
5. Ambiente për bibliotekën, senatin, salla audiovizive, kompjuterësh etj;
6. Ambiente teknike (që i shërbejnë funksionit të godinës si kaldaja, motor generatori, depozita uji dhe elektropompa, depo, kabina elektrike, etj) oborr dhe ambiente të gjelbëruara.

C. Normativa e sipërfaqes së shfrytëzueshme e ndara sipas fushave të studimit, për objektet që do të ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë, është si më poshtë:

| Fusha                              | Sipërfaqja në m <sup>2</sup> për studentë |
|------------------------------------|---|
| Shkencat natyrore                  | 2.5 m <sup>2</sup>                        |
| Inxhinieri dhe teknologji          | 5 m <sup>2</sup>                          |
| Shkenca mjekësore dhe shëndeti     | 5 m <sup>2</sup> /                        |
| Shkenca bujqësore dhe veterinarisë | 2.5 m <sup>2</sup>                        |
| Shkenca sociale                    | 2.5 m <sup>2</sup>                        |
| Shkenca humane dhe arte            | 2.5 m <sup>2</sup>                        |

D. Numri i studentëve sipas veprimtarive akademike, nuk duhet të jetë më i madh se:

| Fusha e studimit                       | Nr.Studentëve/<br>Seminar | Nr.Studentëve/<br>Laborator | Nr.Studentëve/<br>Praktika | Nr.Studentëve/<br>leksion |
|--|---------------------------|-----------------------------|----------------------------|---------------------------|
| Shkenca Natyrore                       | 35                        | 25                          | 25                         | 6 grupe seminari          |
| Inxhinieri & Teknologji                | 25                        | 20                          | 20                         | 6 grupe seminari          |
| Shkenca Mjekësore dhe Shëndetit        | 25                        | 20                          | 20                         | 6 grupe seminari          |
| Shkenca Agrikulturore dhe Veterinarisë | 35                        | 25                          | 25                         | 6 grupe seminari          |
| Shkenca Sociale                        | 35                        | 25                          | 25                         | 6 grupe seminari          |
| Humanitete dhe Arte                    | 35                        | 25                          | 25                         | grupe seminari            |

**VENDIM**

Nr. 419, datë 10.5.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 313, DATË 1.7.2002, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR CAKTIMIN E STRUKTURËS, TË NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE TË POLICISË SË BASHKISË DHE KOMUNËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në pikën 19, të kreut XXXIV, të lidhjes bashkëlidhur vendimit nr. 313, datë 1.7.2002, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Numri maksimal i punonjësve të policisë bashkiake, për Bashkinë e Tiranës, të bëhet 373 (treqind e shtatëdhjetë e tre) veta.

2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë së bashkive dhe komunave të bëhet, gjithsej, 1 200 (një mijë e dyqind) veta.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

**Niko Peleshi****VENDIM**

Nr. 420, datë 10.5.2017

**PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË FËMIJËS REI SHKRETA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr. 18, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2017”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Rei Shkreta, në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

**Niko Peleshi****VENDIM**

Nr. 421, datë 10.5.2017

**PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ. DANIELA KOÇIRAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr. 18, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2017”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të znj. Daniela Koçiraj, në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

**Niko Peleshi**



## VENDIM

Nr. 422, datë 10.5.2017

**PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË  
SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË  
Z. MËRKUR BOZGO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr. 18, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2017”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Mërkur Bozgo, në masën 1 000 000 (një milion) lekë.
  2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
  3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave të institucionit të kurimit.
  4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**

## VENDIM

Nr. 423, datë 10.5.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES  
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE  
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,  
QË PREKEN NGA REALIZIMI I  
PROJEKTIT “URBANIZIM I ZONËS  
INFORMALE NË LAGJEN “18 TETORI”  
LUSHNJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

Faqe | 5914

## VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Urbanizim i zonës informale në lagjen ‘18 Tetori’ Lushnjë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “tokë truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 630 362 (gjashtëqind e tridhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 630 362 (gjashtëqind e tridhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga fondet e Bashkisë Lushnjë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare”.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.





Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi

Vlera e shpronësimit e truallit të z. Lumturi Ali Manlli + bashkëpronare dhe z.Xhevair Beqir Lika  
Si pasoje e investimit "Urbanizimi i zonës informale në lagjen 18 Tetori  
Në lagjen 18 tetori Zona kadastrale 8572  
INVESTITTORI : BASHKIA LUSHNJE

| Nr | N/ pasurisë | Emri Mbiemri                   | Zona kadastrale | Lloji i pronës | Njësia         | Sasia | Çmimi        | Vlera  | Konfirmimi nga ZVRPP-ja          |
|----|-------------|--------------------------------|-----------------|----------------|----------------|-------|--------------|--------|----------------------------------|
| 1  | 25/136      | Lumturi Manlli + bashkëpronare | 8572            | Truall         | m <sup>2</sup> | 51.7  | 8954         | 462922 | Shkresa 1160/1 datë 20/02/2017   |
| 2  | 20/177      | Xhevair Beqir Lika             | 8572            | Truall         | m <sup>2</sup> | 18.7  | 8954         | 167440 | Shkresa nr 451/1 datë 30.01.2017 |
|    |             |                                |                 |                |                |       | Shuma totale | 630362 |                                  |

**VENDIM**  
Nr. 424, datë 10.5.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES E TË EMËRIMIT TË DREJTUESVE TË SHËRBIMIT NË STRUKTURAT SHËNDËTËSORE UNIVERSITARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi në institucionet shëndetësore universitare drejtohet nga drejtuesi i shërbimit, i cili përzgjidhet në bazë konkurrimi.

2. Drejtuesi i shërbimit në momentin e kandidimit duhet të plotësojë kriteret minimale bazë, si më poshtë vijon:

a) Të jetë mjek specialist i diplomuar në fushën e shërbimit për të cilin kandidon;

b) Në rastet kur kandidati ka vetëm shtetësi të huaj, ai duhet të zotërojë certifikatën e mbrojtjes së gjuhës shqipe, me përjashtim të rasteve kur kandidati ka kryer një cikël të plotë studimesh në gjuhën shqipe;

c) Të jetë i regjistruar në urdhrin profesional përkatës;

ç) Të zotërojë titullin "Profesor", "Profesor i Asociuar" ose të ketë Doktoratë/PhD, të mbrojtur në një nga universitetet e BE-së, SHBA-ve, Kanada, Australi apo Japoni. Në rast se asnjë nga pjesëtarët e stafit mjekësor nuk plotëson kriteret e sipërpërmendura, mund të pranohen edhe kandidatë me doktoratë/PhD, të mbrojtur në Shqipëri apo vende të papërmendura më sipër;

d) Të jetë mjek pedagog me kohë të plotë, me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar në IAL-në përkatëse dhe të ketë të njëjtin specialitet në shërbimin shëndetësor universitar, për të cilin kandidon, ose të jetë/të ketë qenë mjek pedagog me kohë të plotë i strukturave universitare homologe të Bashkimit Evropian ose vendeve anëtare të OECD;

dh) Të mos ketë qenë asnjëherë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë;

e) Të mos ketë asnjë dënim të dhënë nga Urdhri i Mjekut;

ë) Të ketë përvojë akademike si pedagog me kohë të plotë, jo më të vogël se 5 (pesë) vjet.

Në rastet kur asnjë nga pjesëtarët e stafit mjekësor nuk plotëson kriterin e sipërpërmendur, mund të pranohen edhe kandidatë me përvojë akademike, jo më të shkurtër se 8 (tetë) vjet, si pedagog me kohë të pjesshme. Konsiderohet përvojë akademike aktiviteti didaktik i kryer në institucione publike të arsimit të lartë apo në institucione jopublike të arsimit të lartë, të akredituara dhe në programe studimi të akredituara brenda vendit, në periudhën e përvojës së kryer. I njëjti kriter vlen dhe për institucionet dhe programet



e akredituara/e njohura në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose vendet anëtare të OECD;

f) Të ketë përvojë klinike/diagnostike jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në specialitetin përkatës.

3. Procedurat për përzgjedhjen e drejtuesit të shërbimit shëndetësor universitar nisin nga rektorati i IAL-së (UMT), me përfundimin e mandatit të radhës, me kërkesë të strukturës shëndetësore universitare përkatëse.

4. Procesi i përzgjedhjes së kandidaturave bëhet nga një komision i posaçëm, i ngritur me urdhër të përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, i cili ka në përbërje të tij një përfaqësues nga Rektorati, Dekanati i IAL-së, struktura shëndetësore universitare, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Shëndetësisë.

5. Komisioni shpall datat dhe bën publike kriteret e vlerësimit të dosjeve.

6. Komisioni organizon punën nëpërmjet sekretariatit të përbashkët me 5 (pesë) anëtarë, të cilët bëjnë verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar për çdo aplikues dhe përputhshmërinë e kriterëve të përcaktuara me këtë vendim.

7. Kandidatët për drejtues të shërbimeve aplikojnë për pozicionin përkatës për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike, duke nisur nga 1 (një) muaj para datës së konkurrimit.

8. Kërkesa shoqërohet me *curriculum vitae*, vetëdeklarimet bazuar në legjislacionin në fuqi, kopje të noterizuar të dokumentacionit përkatës provues të plotësimit të kriterëve dhe të kartës së identitetit, si dhe projektin për zhvillimin e shërbimit. Kërkesa dorëzohet pranë zyrës së burimeve njerëzore të fakultetit, pjesë e të cilit është shërbimi ku do të konkurrojnë, i cili, me përfundimin e afatit për aplikim, ia kalon dokumentacionin sekretariatit të përbashkët.

9. Kandidatët paraqiten ditën e konkurrimit për të kryer intervistën me komisionin, e cila ka për qëllim prezantimin e projektit të kandidatit për zhvillimin dhe drejtimin e shërbimit. Projekti duhet të paraqesë të dhëna dhe produkte konkrete të matshme të cilat do të shërbejnë më pas si bazë për vlerësimin e punës së drejtuesit të ardhshëm të shërbimit që i ka paraqitur ato. Komisioni vlerëson projektin e paraqitur. Angazhimet e paraqitura nga kandidati në projekt bëhen pjesë e kontratës që kandidati lidh nëse ai shpallet fitues me strukturën shëndetësore universitare.

10. Kandidatët konkurrues për një shërbim të caktuar vlerësohen nga komisioni përkatës, sipas përcaktimeve dhe kriterëve të parashikuara në aneksin nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.

11. Komisioni pas shqyrtimit bën renditjen e kandidaturave që aplikojnë për postin e drejtuesit të shërbimit shëndetësor universitar.

12. Komisioni duhet të bëjë transparente rezultatet e vlerësimit.

13. Pas miratimit, komisioni ia dërgon rezultatet e vlerësimit ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Shëndetësisë, të cilët bëjnë emërimin me shkresë të përbashkët.

14. Kandidati fitues lidh kontratën me drejtuesin e strukturës shëndetësore universitare, pjesë e të cilës është shërbimi përkatës.

15. Nëse kandidati fitues vjen nga jashtë strukturave të IAL-së, ai fiton automatikisht edhe pozicionin e pedagogut me kohë të plotë, me kontratë me kohë të pacaktuar pranë IAL-së përkatëse.

16. Drejtuesi i shërbimit drejton shërbimin për 4 (katër) vjet, me të drejtë rikandidimi.

17. Vlerësimi i punës së drejtuesit të shërbimit bëhet përmes vlerësimit të treguesve të performancës si dhe në bazë të detyrimeve kontraktore sipas parashikimeve në kontratën përkatëse të lidhur në momentin e marrjes së detyrës. Vlerësimi i punës është vjetor dhe kryhet nga drejtori i strukturës shëndetësore universitare ku shërbimi në fjalë bën pjesë.

18. Drejtuesi i shërbimit shëndetësor universitar mund të pezullohet dhe të shkarkohet nga detyra sipas Kodit të Punës apo për arsye të tjera të parashikuara me ligj. Pezullimi dhe propozimi për shkarkim mund të bëhen nga titullari i strukturës shëndetësore universitare. Shkarkimi bëhet nga ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Arsimit dhe Sportit, me urdhër të përbashkët.

19. Në rast ndërprerjeje të parakohshme të mandatit të drejtuesit të shërbimit shëndetësor universitar, me propozim të drejtorit të institucionit mjekësor dhe rektorit të IAL-së, ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Arsimit dhe Sportit, me shkresë të përbashkët, komandojnë në këtë detyrë një nga pjesëtarët e stafit akademik me kohë të plotë të shërbimit shëndetësor universitar përkatës. Në këtë rast, brenda 6 (gjashtë) muajve, duhet të organizohet procesi i përzgjedhjes së drejtuesit të ri të shërbimit, mandati i të cilit përfundon në të



njëjtën kohë me atë të drejtuesve të tjerë të shërbimeve shëndetësore universitare të institucionit mjekësor.

20. Në rastet e IAL-ve jopublike procedurat kryhen nga IAL-ja jopublike dhe struktura shëndetësore universitare jopublike përkatëse, sipas statuteve përkatëse dhe udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

21. Shpenzimet, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga institucioni përkatës i arsimit të lartë dhe struktura shëndetësore universitare.

22. Çdo akt, që vjen në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

23. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë, institucionet përkatëse të arsimit të lartë dhe strukturat shëndetësore universitare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi

#### ANEKSI 1

| Nr.  | KRITERET VLERËSUESE TË TJERA   |  |  |
|------|--|--|--|
| 1    | Të zotërojë titullin/gradën në fushën ku aplikon   |  |  |
|      | Profesor   |  |  |
|      | Profesor i Asociuar  |  |  |
|      | PhD të mbrojtur në një nga universitetet e BE-së, SHBA, Kanada, Australi apo Japoni  |  |  |
| 2    | <b>Përvojë drejtuese dhe rezultate pozitive në drejtimin e shërbimeve shëndetësore universitare</b>  |  |  |
| 3    | <b>Aftësi profesionale dhe organizative në QSUT apo struktura të ngjashme shëndetësore universitare</b>  |  |  |
| 4    | Performanca profesionale në fushën ku aplikon  |  |  |
| 5    | <b>Realizimi i procedurave mjekësore të veçanta ( nëse aplikohet)</b>  |  |  |
| 6    | <b>Realizimi i operacioneve kirurgjikale të kategorisë së vështirë ( nëse aplikohet)</b>   |  |  |
| 7    | Integritet etik dhe moral, si dhe konsiderata që zotëron në komunitet  |  |  |
| 8    | <b>Projekti 4-vjeçar i kandidatit për zhvillimin e shërbimit shëndetësor ku aplikon</b>  |  |  |
| 9    | Specializime jashtë vendit në fushën ku aplikon  |  |  |
|      | Afatshkurtër, ≤3 muaj, institucioni  |  |  |
|      | Afatgjatë, >3muaj, institucioni  |  |  |
| 10   | <b>Referime në konferenca shkencore në fushën ku aplikon</b>   |  |  |
| 10.1 | <b>Kategoria 1</b><br>Konferenca shkencore të shoqatave ndërkombëtare: evropiane, botërore dhe nacionale në vendet si BE, Norvegji, Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Australi |  |  |
|      | REFERUES ME GOJE   |  |  |
|      | Autor i parë   |  |  |
|      | Bashkautor   |  |  |
|      | <b>POSTER</b>  |  |  |
|      | Autor i parë   |  |  |
|      | Bashkautor   |  |  |
| 10.2 | <b>Kategoria 2</b><br>Konferenca shkencore të shoqatave ndërkombëtare: rajonale dhe ballkanike   |  |  |
|      | <b>REFERUES ME GOJE</b>  |  |  |
|      | Autor i parë   |  |  |
|      | Bashkautor   |  |  |
|      | <b>POSTER</b>  |  |  |
|      | Autor i parë   |  |  |
|      | Bashkautor   |  |  |



|      |   |  |  |
|------|---|--|--|
| 10.3 | <b>Kategoria 3</b><br><b>Konferenca shkencore të shoqatave kombëtare të vendeve të rajonit që nuk përfshihen në kategorinë 1</b>  |  |  |
|      | <b>REFERUES ME GOJE</b>   |  |  |
|      | Autor i parë  |  |  |
|      | Bashkautor  |  |  |
|      | <b>POSTER</b>   |  |  |
|      | Autor i parë  |  |  |
|      | Bashkautor  |  |  |
| 11   | Artikuj në revista shkencore në fushën ku aplikon   |  |  |
| 11.1 | <b>Kategoria 1</b><br><b>Artikuj në revista shkencore me faktor impakti</b>   |  |  |
|      | Autor i parë<br>Faktori i impaktit  |  |  |
|      | Bashkautor<br>Faktori i impaktit  |  |  |
| 11.2 | <b>Kategoria 2</b><br>Artikuj në revista shkencore pa faktor impakti me bord editorial e ISSN në vendet evropiane, botërore dhe nacionale si BE, Norvegji, Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Australi |  |  |
|      | Autor i parë  |  |  |
|      | Bashkautor  |  |  |
| 11.3 | <b>Kategoria 3</b><br><b>Artikuj në revista shkencore pa faktor impakti me bord editorial e ISSN në Shqipëri dhe vendet e rajonit që nuk janë në të përfshira sipas kategorisë 1.</b>             |  |  |
|      | Autor i parë  |  |  |
|      | Bashkautor  |  |  |
| 12   | <b>Organizator i konferencave apo shkollave, kurseve shkencore edukative në fushën ku aplikon.</b>  |  |  |
| 12.1 | <b>Kategoria 1</b><br><b>Organizator i konferencave të shoqatave ndërkombëtare të organizuara në Shqipëri</b>   |  |  |
| 12.2 | <b>Kategoria 2</b><br><b>Organizator i konferencave të shoqatave ndërkombëtare të organizuara jo në Shqipëri</b>  |  |  |
| 12.3 | <b>Kategoria 3</b><br><b>Organizator i konferencave të organizuara në Shqipëri</b>  |  |  |
| 13   | <b>Pjesëmarrës në projekte të fushës ku aplikon</b>   |  |  |
|      | Drejtues  |  |  |
|      | Pjesëmarrës   |  |  |
| 14   | <b>Anëtar i bordeve shkencore ndërkombëtare në fushën ku aplikon</b>  |  |  |
| 15   | <b>Anëtar i shoqatave ndërkombëtare të profesionistëve në fushën ku aplikon</b>   |  |  |
| 16   | <b>Anëtar i shoqatave kombëtare të profesionistëve në fushën ku aplikon</b>   |  |  |
|      | Drejtues  |  |  |
|      | Anëtar  |  |  |
| 17   | <b>Tekst, monografi në fushën ku aplikon</b>  |  |  |
|      | Jashtë vendit   |  |  |
|      | Brenda vendit të aprovuara nga Këshilli Botues i universitetit/fakultetit   |  |  |
| 18   | <b>Çmime dhe tituj shkencore ndërkombëtarë dhe kombëtarë</b>  |  |  |
| 19   | <b>Arritje profesionale në fushën ku aplikon</b>  |  |  |
| 20   | <b>Të tjera</b>   |  |  |

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 292, datë 3.4.2017 vendosi të shpallë të zhdukur shtetasin Pëllump (Pëllumb) Beqiraj dhe caktimin e kërkuesit Flamur Beqiraj si kujdestar për administrimin e pasurive të tij.

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 168 lekë